



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2164/6 prot.

Datë 03.09.2025

**V E N D I M**

**Nr. 1181/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 03.09.2025 u shqyrtua ankesa me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj. Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tropojë me adresë: Sheshi “Azem Hajdari”, Qyteti Bajram Curri.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Cara” SHPK me NUIS K07729920F dhe adresë: Lagjja “Pjetër Budi”, Rruga “Abdi Mati”, Ndërtesë private Nr.10, Mat.

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.06.2025, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj. Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

II.2. Në datën 30.07.2025, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

|  |                                  |
|--|----------------------------------|
| “Cara” SHPK  | 49,492,162.00 lekë, skualifikuar |
| “Rroku Guest” SHPK                                     | 51,608.130.00 lekë, skualifikuar |
| “Nika” SHPK  | 52,237,931.13 lekë, skualifikuar |
| “Florida” SHPK   | 53,008,379.00 lekë, skualifikuar |
| BOE “HTSH” SHPK & “Smovataksi” SHPK                    | 56,731,541.00 lekë, skualifikuar |
| BOE “Desaret Company” SHPK & “R.S.M Construction” SHPK | 60,562,584.77 lekë, skualifikuar |
| BOE “Griald” SHPK & “Ina” SHPK & “Vllaznimi” SHPK      | 63,823,998.00 lekë, kualifikuar  |
| “Company Riviera 2008” SHPK                            | 69,573,047.00 lekë, skualifikuar |
| “Trajler” SHPK   | 70,492,692.24 lekë, skualifikuar |
| “Alb Tiefbau” SHPK                                     | 71,828,938.92 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Cara” SHPK është skualifikuar me argumentin e të gjithë anëtarëve të KVO-së si vijon:

*“... Preventivi i paraqitur nga ky OE është me gabime, pasi nuk përputhen vlerat dhe shumat dhe shumata totale nëse mblidhen të gjitha shumat së bashku del ndryshe dhe ndryshon vlerën e ofertës.”*

Një anëtar i KVO-së, pretendon gjithashtu se: *“ Puna e ngjashme e paraqitur nga operatori nuk plotëson kriterin sepse nuk është një punë e ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi puna e ngjashme që ka paraqitur operatori është "Ndërtim dhe rehabilitim i ish repartit ushtarak Surrel-Tiranë.”*

II.3. Në datën 05.08.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 11.08.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2025/5660, protokolluar me nr.2164/2025 prot, datë 11.08.2025, i operatorit ekonomik “Cara” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: *“Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj. Dragobisë–Qafë Pajë”*, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Në mesazhin elektronik të ardhur me datë 30.07.2025, ora 11:11 në faqen e portalit unik të APP-së nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tropojë për objektin: “Ndërtim Rruge Kika - Bradozhnic (Kika - Gj. Dragobisë - Qafë Pajës Pjesa e I-rë) “, me fond limit: 82,911,061.31 (tetëdhjetë e dy milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e një pikë tridhjetë e një) lekë pa TVSH, të zhvilluar me datë 15.07.2025 ora 11:00 oferta juaj është refuzuar.*

*- Preventi i OE ka shumë gabime që ndryshojnë vlerën e ofertës së paraqitur.*

- Puna e ngjashme e paraqitur nga OE nuk plotëson kriterin.

Operatori Ekonomik "CARA" sh.p.k referuar në vlerësimin e KVO-së të AK nuk është dakord për arsye ku thuhet se oferta është refuzuar.

- Nga korigjimi i bërë i preventivit të paraqitur në ofertën e datë 15.07.2025 vlera sipas llogaritjeve del ekzaktësisht si vijon:

Preventivi i ofertës është pa tvsh në shumën: lekë 49,492,162

Preventivi i korigjuar është pa tvsh në shumën: lekë 49,489,623

Diferenca ose gabimi aritmetik është pa tvsh në shumën: leke 2,539

Në përqindje gabimi aritmetik është: 0.005130105%

Duke qenë se vlerat është punuar me shifra pas presjes janë marre nga komisioni të rrumbullakosura. Gabimet aritmetike të rrumbullakosur matematikisht janë në vlerë të vogël dhe minimale në 0.005130105%.

- Puna e ngjashme e paraqitur nga OE e plotëson kriterin dst.

Plotësojmë 100% (njëqind për qind) kërkesat sipas dst-së të Ndërtimit.

Shiko të gjithë dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të Ndeërtimit. Bazuar në fakte dhe argumente e dokumentat qe disponojmë e që kemi paraqitur në tender dhe sipas kërkesës dhe përgjigje kërkesës. Kërkojmë nga ana e KVO-së të AK-ës që të bëhet kualifikimi i OE-së për më tej. Bashkëlidhur kësaj ankese keni këto dokumenta si vijon:

1. Preventivin e ofertës së paraqitur në Ndërtim.

2. Preventivin e ofertës të korigjuar.

3. Punimet ngjashme ndodhen në SPE.

4. Me datë 30.07.2024, ora 11:11, në mesazhin elektronik në faqen e portalit unik të APP-së nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tropojë për objektin: "Ndërtim Rruge Kika - Bradozhnic (Kika - Gj.Dragobisë - Qafë Pajës Pjesa e I-rë)", oferta juaj është refuzuar.

5. Me datë 05.08.2025 ora 11:55, njoftim fituesi, ka nisur afati i ankimimit për procedurën me numër reference: REF-52709-06-27-2025.

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2164/1 Prot., datë 12.08.2025.

II.6. Në datën 25.08.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2164/2 prot., vendimi nr.2 i KSHA-së, nr. 3694/2 prot., datë 22.08.2025 drejtuar shoqërisë "Cara" SHPK dhe KPP-së si dhe në datën 27.08.2025 është protokolluar në KPP me nr. 2164/3 shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3694/4 prot., datë 22.08.2025 me objekt: "Informacion mbi trajtimin e ankesës së OE "Cara" SHPK, vendimi i KSHA-së për trajtimin e ankesës së shoqërisë "Cara" SHPK. Referuar këtij vendimi rezulton se ankesa e ankimuesit është refuzuar, duke argumentuar si vijon:

"[...]"

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave analizoi pretendimet e arsyet e skualifikimit nga ana juaj. KSHA gjykoi se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh.

**Arsyetimi:** Referuar DST-së objekt prokurimi në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, nenit 26 pika 2/i si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26 të VKM- së, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, (përsa i përket ofertave i referohemi dokumentave të cilat njësia e prokurimit i kërkon të ngarkohen në SPE, për të gjithë operatorët ekonomikë). Bazuar në këtë pikë të DST-së dhe ligjin 162/2020 “ Për rregullat e prokurimit publik” dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik për plotësimin e kriterëve për kualifikim rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST.

1. Duke u nisur nga formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit ka mangësi në plotësimin e disa pikave të saj. Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A. Deklaratat:

-OE nuk është shpallur fajtor për shkelje të rënda profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi, paplotësuar.

- OE nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, pa plotësuar.

-OE ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi pa plotësuar.

-OE ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi pa plotësuar.

2. Vazhdojmë me arsyen e radhës, ky operator ekonomik ka sjellë preventivin jo të saktë, nuk korrespondon shuma në raport, çmim x sasi.

3. Te kapacitetet teknike pika 2.3.4 mungon inxhinier gjeodet/topograf/gjeomatik

4. Te pika 2.3.4 te kriteri mjete dhe pajisje mungojnë:

-elektrokompresor

- sondez 300 pa manov ose pajisje ekuivalente me të.

-betoniere 500 L

-vibrator thellësie

-makineri për montim guard rail

5. Përvoja e mëparshme, nuk plotësohet si kriter, pasi nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit tonë dhe nuk përmban zëra të ngjashëm si e jona.

Pra dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST.

*Pas verifikimit të dokumentacionit provues për pretendimet e ngritura nga ana e juaj, KSHA arrin në përfundim se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh.”*

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Preventivi i paraqitur nga ky OE është me gabime, pasi nuk përputhen vlerat dhe shumat dhe shuma totale nëse mbledhen të gjitha shumat së bashku del ndryshe dhe ndryshon vlerën e ofertës”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 1 dhe 2 të dokumenteve të tenderit për procedurën e mësipërme të prokurimit, është parashikuar si më poshtë vijon:

#### ***Shtojca 1.***

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

#### ***FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>1</sup>***

*Data:*

*Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:*

*Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]*

*Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]*

*Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

---

<sup>1</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontratës;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b>                               |  |

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**

**Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

| <b>Nr.</b>           | <b>Nr. Analizë</b> | <b>Përshkrimi i Punëve</b> | <b>Njësi</b> | <b>Sasia</b> | <b>Çmimi/Njësi</b> | <b>Çmimi total</b> |
|----------------------|--------------------|----------------------------|--------------|--------------|--------------------|--------------------|
| 1.                   |                    |                            |              |              |                    |                    |
| 2.                   |                    |                            |              |              |                    |                    |
| 3.                   |                    |                            |              |              |                    |                    |
|                      |                    |                            |              |              |                    |                    |
| <b>Shuma</b>         |                    |                            |              |              |                    |                    |
| <b>Fondi Rezervë</b> |                    |                            |              |              |                    |                    |
| <b>Shuma</b>         |                    |                            |              |              |                    |                    |
| <b>TVSH</b>          |                    |                            |              |              |                    |                    |
| <b>SHUMA TOTAL</b>   |                    |                            |              |              |                    |                    |

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_\_ (e kërkuar në dokumentet e tenderit)**

III.1.2. Sipas shtojcës të publikuar në SPE me preventivin e zërave të punimeve, rezulton se nga AK është parashikuar si vijon:

### PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndertim Rruge Kika - Bradozhnic  
( Kika - Gj.Dragobise - Qafe Pajes Pjesa e I-rë)

| Nr                               | Nr. Analiz. | Pershkrimi i Punimeve   | Njesia | Sasia | Çmimi Manuali | Vlera |
|----------------------------------|-------------|---|--------|-------|---------------|-------|
| <b>I. PUNIME TE PERGJITHSHME</b> |             |   |        |       |               |       |
| 1                                | 3.2         | Prerje bime te vogla ø-10cm   | m2     | 7200  |               |       |
| 2                                | 3.3         | Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm   | cope   | 160   |               |       |
| 3                                | 3.4         | Prerje e sistemim pemesh ø 21 - 40 cm   | cope   | 40    |               |       |
| 4                                | 3.5         | Prerje e sistemim pemesh ø 41- 75 cm  | cope   | 15    |               |       |
| 6                                | 3.87/b      | Germim dheu me ekskavator goma, 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke    | m3     | 200   |               |       |
| 7                                | 3.89/a      | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet  | m3     | 621   |               |       |
| 10                               | 3.104/a     | Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet | m3     | 2860  |               |       |
| 11                               | 3.104/b     | Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet   | m3     | 13800 |               |       |
| 12                               | 3.772       | Germim sek.i lire e ngarkim mbi mjet, shkemb i zakonshem  | m3     | 3680  |               |       |
| 13                               | 3.772/1     | Germim ne sek.lire e ngarkim mbi mjet, shkemb i forte   | m3     | 320   |               |       |
| 14                               | 3.353       | Mbushje me shkemb te germuar me pare per trup rruge   | m3     | 1920  |               |       |
| 15                               | 3.161/1     | Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.5 m <sup>3</sup>  | m2     | 25080 |               |       |
| 16                               | 3.158/2a    | Transport dheu me auto deri 2.0 km  | m3     | 20660 |               |       |
|                                  |             |   |        |       | Shuma 1       | -     |
| <b>II. PUNIME VEPRA ARTI</b>     |             |   |        |       |               |       |
| <b>a- Punime mure e tombino</b>  |             |   |        |       |               |       |
| 1                                | 3.87/a      | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke  | m3     | 450   |               |       |
| 2                                | 3.25/a      | Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak.   | m3     | 100   |               |       |
| 9                                | 3.25/b      | Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.   | m3     | 50    |               |       |
| 3                                | 3.396       | Mbushje me cakell pas mureve e tombinove  | m3     | 600   |               |       |
| 5                                | 3.376       | Ndertim drenazhi, mbushje me gure kave  | m3     | 30    |               |       |
| 6                                | 3.366       | Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni  | m      | 84    |               |       |
| 7                                | 3.237       | Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur  | m3     | 1592  |               |       |
| 8                                | 3.244       | Struktura monolite betoni C 20/25 (puseta)  | m3     | 56    |               |       |
| 8                                | 3.244       | Struktura monolite betoni C 20/25 (breza)   | m3     | 25    |               |       |
| 9                                | 3.654       | Furr. Vendorsje tuba plastik Ø 100 mm (vrime kullimi ne mure)   | ml     | 150   |               |       |
|                                  |             |   |        |       | Shuma a       | -     |
| <b>b- Ndertim Ure Hd = 4m</b>    |             |   |        |       |               |       |
| 1                                | 3.97/a      | Germim me eskav.me zinxhir 0.25 m <sup>3</sup> kanale me gjersi-2m, shkarkim ne toke                                      | m3     | 60    |               |       |
| 2                                | 3.98/b      | Germim me skav. me zinxhir 0.25 m <sup>3</sup> kanale me gjersi-2m , me shkarkim ne toke                                  | m3     | 20    |               |       |
| 3                                | 3.25/c      | Germim me krah seksion i detyruar me gjersi b > 1 m , h-1.5m toke e zakonshme   | m3     | 10    |               |       |
| 4                                | 3.237       | Struktur monolite b/betoni C-12/15 me 20%gur (themeli i Ures)   | m3     | 32    |               |       |
| 5                                | 3.243       | Struktur monolite betoni C- 16/20 (ballnat)   | m3     | 43    |               |       |
| 6                                | 3.244       | Struktur monolite betoni C- 20/25 (jasteku)   | m3     | 1.3   |               |       |
| 7                                | 3.244       | Struktur monolite betoni C- 20/25 (bordura + breza)   | m3     | 2.8   |               |       |
| 8                                | 3.237       | Struktur monolite b/betoni C-12/15 me 20%gur (shpatullat e Ures)  | m3     | 60.2  |               |       |
| 9                                | 3.245/1     | Struktur e holle monolite Betoni C 25/30 (Solet e bordur)   | m3     | 6.0   |               |       |
| 10                               | 3.287       | F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6-10 mm   | ton    | 0.30  |               |       |
| 11                               | 3.288       | F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm   | ton    | 0.64  |               |       |
| 12                               | 3.353       | Mbushje me shkemb te germuar me pare pas mureve   | m3     | 30    |               |       |
| 13                               | 3.208       | Shtres makadam 10cm perhap e ngjesh me makineri   | m2     | 40    |               |       |
| 14                               | 3.654       | Furr. Vendorsje tuba plastik Ø 100 mm   | ml     | 18    |               |       |
| 15                               | 2.181       | Konstruksione metalike te thjeshta (pamak ure)  | ton    | 0.14  |               |       |
|                                  |             |   |        |       | Shuma b       | -     |
|                                  |             |   |        |       | Shuma 2       | -     |

| III. PUNIME SHITESASH   |         |   |                    |         |                       |
|-------------------------|---------|---|--------------------|---------|-----------------------|
| 1                       | 3.211   | Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri | m2                 | 450     |                       |
| 2                       | 3.212   | Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri    | m2                 | 45600   |                       |
| 3                       | 3.212/a | Shtrese stabilizanti t=5cm  | m2                 | 25600   |                       |
|                         |         |   |                    |         | Shuma 3               |
| IV. PUNIME SINJALISTIKE |         |   |                    |         |                       |
| 1                       | 3.931/1 | F.v. panele plotesuese model 5 normal 15x35                         | cope               | 10      |                       |
| 2                       | 3.935/1 | F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60                        | cope               | 10      |                       |
| 3                       | 3.936   | F.v. Tabela trekendore e vogel me A = 60                            | cope               | 20      |                       |
| 4                       | 3.941/4 | F.v. Pervijues modulare te kthesave (gilte)                         | cope               | 30      |                       |
| 5                       | 3.956   | FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti              | cope               | 1       |                       |
|                         |         |   |                    | shuma   | Shuma 4               |
| V. DIFERENC TE NDRYSHME |         |   |                    |         |                       |
| 1                       | 3.183   | F.V guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W2                 | ml                 | 60      |                       |
| 2                       | 3.919   | F.V - fundore guardrail me 2 valez.                                 | cope               | 4       |                       |
| 3                       | An      | Transport Inerte per betone, çimento etjer                          | t <sup>3</sup> /km | 28800   |                       |
|                         |         |   |                    | shuma 3 | Shuma 5               |
|                         |         |   |                    |         | shuma 1-5             |
|                         |         |   |                    |         | Fonde Rezerve 2%      |
|                         |         |   |                    |         | Siguria ne kantier 3% |
|                         |         |   |                    |         | Shuma Pa TVSH         |
|                         |         |   |                    |         | T.V.SH 20%            |
|                         |         |   |                    |         | SHUMA TOTALE          |

III.1.3.Nga verifikimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Cara” SHPK rezulton, se Formulari i Ofertës ekonomike përmban çmimin total të ofertës pa tvsh në vlerën 49.492.162 lekë, dhe çmimi total i ofertës me tvsh është plotësuar në vlerën 59.390.594 lekë.

Ndërsa shtojca 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, rezulton e plotësuar me të gjithë zërat e saj dhe përmban gjithashtu sasi të dhe çmimet për njësi me vlerat përkatëse.

III.1.4. Në ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik shoqëria “Cara” SHPK argumenton se:

“ [...] Nga korrigjimi i bere i preventivit te paraqitur ne oferten e date 15.07.2025 vlera sipas llogaritjeve del ekzaktesisht si vijon :

Preventivi i ofertes eshte pa tvsh ne shumen: leke 49,492,162

Preventivi i korrigjuar eshte pa tvsh ne shumen: leke 49,489,623

Diferenca ose gabimi aritmetik eshte pa tvsh ne shumen: leke 2,539

Ne perqindje gabimi aritmetik eshte: 0.005130105%

Duke qene se vlerat eshte punuar me shifra pas presjes jane marre nga komisioni te rrumbullakosura. Gabimet aritmetike te rrumbullakosur matematikisht jane ne vlere te vogel dhe minimale ne 0.005130105 %. [...]”

III.1.5. Në vendimin e KSHA për ankesën e paraqitur nga shoqëria “CARA” shpk, është gjykuar se: “[...] Vazhdojmë me arsyen e radhës, ky operator ekonomik ka sjellë preventivin jo të saktë, nuk korespondon shuma në raport çmim x sasi. ”

III.1.6. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e

*operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.7. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.8. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

III.1.9. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*
- 2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*
- 3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.10. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 3, thuhet shprehimisht:

“3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: - shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; - shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.”

III.1.11. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

III.1.12. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, operatori ekonomik “Cara” SHPK ka paraqitur Shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe shtojcën 2 me emërtimin “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, pjesë e ofertës së tij. Nga shqyrtimi i formularit të ofertës

dhe listës së çmimeve të ofruara nga ankimuesi, për procedurën e mësipërme të prokurimit konstatohet, se oferta ekonomike e paraqitur përmban gabime aritmetike, që rezultojnë nga herësi i sasisë së zërave të punimeve sipas preventivit dhe çmimeve përkatëse për njësi. Pra, rezulton se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Cara” SHPK ka gabime aritmetike dhe në rastin konkret ka mospërputhje, ndërmjet çmimeve për njësi dhe çmimeve në total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, ndaj dhe në, përputhje me nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 3, duke qënë se çmimi i njësisë mbizotëron kundrejt çmimit në total, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bënte rilogaritjet, duke korigjuar çmimet në total për secilin zë dhe në vijimësi. Në rast se shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, oferta duhet të refuzohet dhe në rastin kur shumat absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit pranimin e korigjimit. Vetëm në rast se ofertuesi nuk e pranon këtë korigjim, oferta e tij duhet refuzuar.

Në rastin në fjalë nga ana e autoritetit kontraktor nuk jepet asnjë sqarim për veprimet e ndërmarra nga ky i fundit, lidhur me sa është konstatuar nga KVO-ja, për më tepër nuk jepen sqarime sa është vlera absolute e gabimit, për të gjykuar nëse gabimi i konstatuar në ofertë është mbi apo nën 2% të vlerës së ofruar.

Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Cara” SHPK ka plotësuar në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, si dhe çmimin total të ofertës me TVSH, ndërkohë referuar shtojcës 2 LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT rezulton se operatori ekonomik ka përcaktuar vlerën e zërave të përcaktuar në preventivin e procedurës objekt ankimi duke përcaktuar vlerën pa TVSH, Fondin Rezervë, Sigurinë në Kantier, Shumën pa TVSH, TVSH-në dhe Shumën në Total. Nga përllogaritjet e kryera konstatohet se shumata absolute e të gjitha gabimeve të rezultuar nga shumëzimi i sasisë me çmimin për njësi për secilin nga zërat e preventivit, nuk e kalon 2% të çmimit total të ofertës.

Në këto kushte autoriteti kontraktor duhet të ndjekë hapat proceduriale, duke e vënë në dijeni ofertuesin për gabimet e konstatuara në ofertën e tij, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik si më sipër cituar. Oferta refuzohet vetëm nëse shumata absolute e të gjitha korigjimeve që rezultojnë më pak se 2% e ofertës, nuk pranohen nga ofertuesi.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Cara” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, për kontratat e ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar raportit të auditit, dy prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO) kanë të njëjtin vlerësim për ofertën e paraqitur nga ky operator ekonomik. Anëtari i tretë i komisionit të vlerësimit të ofertave ka një vlerësim pjesërisht ndryshe nga vlerësimi i dy anëtarëve të tjerë të KVO, duke shtuar argumentin: *“Puna e ngjashme e paraqitur nga operatori nuk plotëson kriterin sepse nuk është një punë e ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi, puna e*

*ngjashme që ka paraqitur operatori është “Ndërtim dhe rehabilitim i ish-repartit ushtarak Surrel-Tiranë”.*

Për pasojë, sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Cara” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së tij, arsye të përdorura vetëm nga njëri prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjisllacioni, janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Neni 110 e vijues i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe neni 94 pika 1, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkon shprehimisht që ankimuesi, duhet të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. KPP gjykon, se arsyet e skualifikimit të cilat janë përdorur/ngritur vetëm nga 1 (një) prej 3 (tre) anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, janë një mendim pakice dhe nuk kanë sjellë pasoja që mund të dëmtonin interesat e ankimuesit, në kuptim të nenit 14 pika 11 “Shumica e nevojshme për të marrë vendime”, të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”. Në këto kushte, për sa kohë operatori ekonomik ankimues nuk është dëmtuar nga kjo arsye skualifikimi, pasi nuk është marrë nga shumica e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, pretendimet e tij për kundërshtimin e këtyre arsyeve të skualifikimit, nuk do të merren në shqyrtim.

III.3. Së fundi, KPP konstaton se në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit KSHA ka shtuar pretendime/arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues të cilat nuk i janë komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO. Konkretisht janë shtuar arsye skualifikimi si vijon:

*“1. Duke u nisur nga formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit ka mangësi në plotësimin e disa pikave të saj. Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A. Deklaratat:*

*-OE nuk është shpallur fajtor për shkelje të rënda profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjisllacionit në fuqi, pa plotësuar.*

*- OE nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, pa plotësuar.*

*-OE ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi pa plotësuar.*

*-OE ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi pa plotësuar.*

*3. Te kapacitetet teknike pika 2.3.4 mungon inxhinier gjeodet/topograf/gjeomatik*

*4. Te pika 2.3.4 te kriteri mjete dhe pajisje mungojnë:*

*-elektrokompresor*

*- sondez 300 pa manov ose pajisje ekuivalente me të.*

*-betoniere 500 L*

*-vibrator thellësie*

*-makineri për montim guard rail*

*5. Përvoja e mëparshme, nuk plotësohet si kriter, pasi nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit tonë dhe nuk përmban zëra të ngjashëm si e jona.*

*Pra dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST.”*

III.3.1. Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“1. Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

*a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;*

*b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.*

*2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.*

*3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi*

*4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj*

III.3.2 Në nenin 82 pika 2 të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”*

III.3.3. Në nenin 113, pika, të ligjit nr.162/2020, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për*

*përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.*

*2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.*

III.3.4. Në kreun X “Zhvillimi i Procedurave”, neni 101, të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: 1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës. Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.”

III.3.5. Gjithashtu në nenin 94 të Vendimit nr 285 të Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.*

III.3.6. Në nenin 102 pika 1 të Vendimit Nr.285 të Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla,

autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 4 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënie e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 i ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Cara” SHPK si dhe ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.3.8. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni Neni 94 i VKM nr.285 datë 19.05.2021, nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

